



FEDERATA E KARATESE E KOSOVËS KOSOVA KARATE FEDERATION



RREGULLORJA E KOMISIONIT TE PARAKARATESË



Neni 1.- DISPOZITAT E PERGJITHSHME

1.1. Roll i Komisionit te Para-Karatese

Para-Karate i referohet një lloji të Karatesë në të cilin janë të inkorporuara disa rregulla të garave për të realizuar një event kompetitivë(garë) midis atletëve me aftësi të kufizuara. Para-Karate është pjesë e integruar e punës të Federatës të Karatesë të Kosovës. Komisioni i Para-Karate është organ këshillues dhe organizues i FKK-së për çështjet të Para-Karatesë. Komisioni i Para-Karatesë do të mbikëqyrë aktivitetet e Para-Karatesë të kryera nën kujdesin e FKK-së dhe ky komision përfaqëson interesat e Para-Karatesë dhe atletëve të saj

Komisioni i Para-Karatesë është pjesë e strukturave të FKK-së.

Komisioni i Para-Karatesë i raporton Bordit të FKK-së.

1.2. Anëtarët e Komisionit të Para-Karatesë

Komisioni i Para-Karatesë do të përbëhet nga Kryetari i Komisionit të Para-Karatesë dhe dy anëtarëve të emëruar nga kryetari i komisionit të aprovuar nga nga Bordi i FKK-së. Kryetari i komisionit zgjedhet me konkurs. Ai/ajo është zëdhënësi i komisionit.

1.3. Kriteret e përzgjedhjes së kryesuesit të Komisionit të Para-Karatesë:

- a) CV-ja
- b) Njohja e rregullave të karatesë në përgjithësi, e në veçanti të para-karatesë
- c) Të ketë përvojë 3 vjeçare në karate si trajner
- d) Përvojë pune me persona me aftësi të kufizuar
- e) Plan pune për zhvillim të para-karatesë
- f) Aplikacioni i FKK-së i plotësuar

Neni 2.- DETYRAT DHE OBLIGIMET E KOMISIONIT TE PARA-KARATESE

- 2.1. Të këshillojë Komisionet e FKK-së në të gjitha llojet e çështjeve në lidhje me Para-Karate.
- 2.2. Të elaborojë dhe paraqesë për miratim në Bordin e FKK-së, përmes Komisionit të Garave dhe Komisionit të Gjyqtarëve, të gjitha Rregullat dhe Rregulloret që lidhen me garat në Para-Karate.
- 2.3. Të organizojë takime dhe të raportojë me informacione të duhura në lidhje me Para-Karate në organet kompetente të FKK-së.
- 2.4. Në bashkëpunim me Bordin të FKK-së, përmes Komisionit të Garave, të studiojë dhe propozojë modifikimin e rregullave të garave në Para-Karate.
- 2.5. Komisioni për Para-Karate mund, me marrëveshje me Kryetarin/Bordit Ekzekutiv, të thërrasë takime të anëtarëve të komisionit për të diskutuar çështje në lidhje me zhvillimin e Para-Karatesë në të gjithë botën dhe për të propozuar takime me Komisionet Kontinentale të Para-Karatesë dhe / ose institucione të tjera që mund të kontribuojnë në zhvillimin e Para-Karatesë në një nivel ndërkombëtar.



- 2.6. Takimet e Komisionit të Para-Karatesë do të koordinohen dhe do të regjistrohen nga brenda. Procesverbali do t'u dërgohet anëtarëve të Komisionit të Parakaratese dhe Bordit Ekzekutiv/Kryetarit të FKK-së, me një kopje në selinë e FKK-së.
- 2.7. Të mbikëqyrë të gjitha Kampionatet Shtetërore në Para-Karate dhe ngjarjet zyrtare të FKK-së në aktivitete të Para-Karatesë.
- 2.8 Të zhvillojë përpara çdo Kampionati Shtetërorë një takim me Trajnerët e licencuar të FKK-së gjatë Takimeve të Rregullta të Trajnerëve që i organizon FKK-ja si dhe takimeve me Kryetarin i Komisionit të Garave për çështje organizative, përgatitore, shortin, etj.
- 2.9 Të mbështesë Komisionin e Gjyqtarëve në mënyrë që të informojë Gjyqtarët për të siguruar që rregullat e Kampionatit të Para-Karatesë të zbatohen në mënyrë të rregullt.

Neni 3.- DETYRAT DHE OBLIGIMET E KRYETARIT TE KOMISIONIT TE PARA-KARATESE

- 3.1. Të përfaqësojë Komisionin për Para-Karate.
- 3.2. Të thërras dhe kryesoj takimet e Komisionit të Para-Karatesë.
- 3.3. Te elaborojë axhendat e takimit duke përfshirë çështjet e propozuara nga pjesëmarrësit e tjerë të takimit.
- 3.4. Te merr të gjitha masat dhe dispozitat e nevojshme për mbarëvajtjen e takimeve.
- 3.5. T'i propozojë Presidentit dhe Bordit të FKK-së për idetë në Para-Karate si dhe të gjitha masat që sipas mendimit të Komisionit të Para-Karatesë, mund të çojnë në përmirësimin e sportit të Para-Karatesë.
- 3.6. Të informojë te gjitha komisionet e FKK-së për të gjitha rekomandimet dhe vendimet e miratuara nga Komisioni për Para-Karate.

Neni 4.- FUNKSIONET E KOMISIONIT TE PARA-KARATESE

- 4.1. Komisioni i Para-Karatesë do të mbledhet në seancë të zakonshme të paktën një herë në vit, gjatë Kampionatit Shtetërorë të FKK-së . Takimet do të thirren nga Kryetari i Komisionit të Para-Karatesë, duke bashkëngjitur axhendën e propozuar.
- 4.2 Rezolutat e Komisionit të Para-Karatese do të miratohen me shumicë të thjeshtë. Në rast barazimi, Kryetari është përcaktues në vendimin përfundimtarë.

Neni 5.- KODI I SJELLJES

Para-atletët kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë për shkak të situatës dhe pozitës së tyre të veçantë, kështu që atletët e Para-Karatesë duhet të ndjehen të lirë të paraqesin çdo çështje përpara Komisionit të Para-Karatese siç mund të bëjnë edhe në Komisionin e Garave. Çështjet që sjellen në Komisionin për Para-Karate nga Atletët e Para-Karatesë duhet të trajtohen në mënyrë diskrete nga anëtarët e Komisionit.

Zyrtarët e Para-Karatesë priten të përmbushin detyrat e tyre dhe të veprojnë në përputhje



me rregullat dhe dokumentet drejtuese të FKK-së, të ndjekin Kodin e Etikës dhe Disiplinës të FKK-së dhe të respektojnë konfidencialitetin në punën e tyre.

Neni 6 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

6.1 Anëtarët e Komisionit do të kompensohen për punën e tyre në komision sipas Rregullores së Mëditjeve dhe vendimit të Bordit Ekzekutiv të FKK-së.

6.2 Garat në para-karate do të mbahen sipas rregullores për Para-Karate të WKF-it.

6.3 Kjo rregullore hynë në fuqi pas aprovimit nga Bordi Ekzekutiv dhe nënshkrimi nga kryetari i FKK-së.

Prishtinë, 19 qershor 2021

Ismet Krasniqi

Kryetar